



KONTRATA E PAJTIMITARIT PER SHERBIMIN INTERNET

NE RRJETIN E OPERATORIT:

ACENET SH.P.K

NR. _____

DATE. ___/___/201___

Kjo kontrate lidhet ndermjet:

Sipermarresit : **ACENET sh.p.k** me Nipt: L63728403 C, Operator i Autorizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare per ofrimin Rrjetit dhe sherbimit Internet, qe me poshte do te quhet OPERATOR , me seli ne adresen Lagjja Clirimi, Rr. Uan Kondakciu Godina 41/136 Lushnje, i perfaqesuar nga **Z. Brunild Gashi**,

Dhe

Z/Znj: _____, me adrese _____,

me dokument identifikimi Nr: _____, qe me poshte do te quhet **PAJTIMITAR.**

KATEGORIA E PAJTIMITARIT:

SHERBIMI INTERNET

FAMILJAR

BIZNES

TJETER

BAZA LIGJORE

Kjo Kontrate hartohet ne zbatim te :

1. Ligjit Nr. 9918 date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar;
2. Ligjit Nr. 9902 date 17.04.2008 "Per Mbrojtjen e Konsumatoreve" i ndryshuar;
3. Ligjit Nr. 9887 date 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale" i ndryshuar;
4. Ligje dhe akte nenligjore qe rregullojne kete marredhenie ne Republiken e Shqiperise.

KUSHTE TE KONTRATES

Neni 1. OBJEKTI KONTRATES

Ofrimi i Sherbimit Internet nga Operatori nepermjet rrjetit te tij te komunikimeve elektronike me specififikimet e dhena ne aneks.

Neni 2 Tarifat

1. Sherbimet, parametrat kryesore te cilesise dhe tarifate te ofruara nga Operatori dhe te pranuar nga Pajtimtari, paraqiten ne Aneksin e kesaj Kontrate dhe jane pjese integrale e Kontrates se nenshkruar midis paleve.
2. Tarifate e Sherbimeve jane objekt ndryshimi, te cilat vendosen dhe publikohen sipas kerkesave te ligjit Nr.9918, date 19.05.2008, "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar. Tarifate publikohen te perditesuara ne faqen tone web www.acenet.al.

Neni 3 DETYRIMET

3.1 OPERATORI DETYROHET :

- 3.1.1 Te mundesoje ofrimin e Sherbimit internet per Pajtimtarin te pandrprere 24 ne 24 ore e me cilesi, si dhe te siguroje shpejtesine e transmetimit te percaktuar ne nenin 1.
- 3.1.2 Te aktivizoje ofrimin e Sherbimit internet brenda dy diteve pune nga data e nenshkrimit te kontrates.
- 3.1.3 Te evidentoje ankesat dhe shqetesimet e Pajtimtarit dhe ta informoje ate per zgjidhjen e mundshme te tyre brenda 3 (tre) diteve pune.
- 3.1.4 Te riparoje defektet teknike dhe te rivendose ofrimin e sherbimit brenda 3 (tre) diteve kalendarike, llogaritur nga momenti i njoftimit ne numrat e informacionit te Operatorit.
- 3.1.5 Te riaktivizoje sherbimin brenda 24 (njetzetkater) oreve, nga momenti qe Pajtimtari ka shlyer te gjitha detyrimet financiare te prapambetura.
- 3.1.6 Te njoftoje nepermjet medias dhe afishimeve, prane njesise ankimore e zyrave te tij, cdo ndryshim te tarifave te Sherbimit te internetit, jo me vone se 15 dite kalendarike, perpara zbatimit te tyre.
- 3.1.7 Pas kerkeses me shkrim, te beje ndryshimin e paketes se internetit ose shpejtesise se transmetimit dite e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore.
- 3.1.8 Pas kerkeses me shkrim per prishje kontrate, te beje nderprerjen e Sherbimit internetit dite e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore.
- 3.1.9 Operatori nuk mban pergjegjesi per problemet apo defektet qe mund te vijne si pasoje e perdorimit te internetit ne menyre te pavarur nga Pajtimtari si psh. hapjes se faqevete ne ndryshme Interneti, shkakimit te programeve nga Interneti, demtimi nga viruset, aplikimi i formave te pagesave online, etj.
- 3.1.10 Te njoftoje Pajtimtarin per modifikime te kesaj Kontrate jo me vone se 30 dite perpara dates se hyrjes ne fuqi te ketyre modifikimeve.
- 3.1.11 Te pergatis, Kontraten dhe gjithe elementet e saj, ne format te printuar, lehtesisht te lexueshem dhe te kuptueshem.
- 3.1.12 Me kerkesen e Pajtimtarit, ben Kontraten te disponueshme per Pajtimtarin ne format te pershtshem per te plotesuar nevojat e personave me aftesi te kufizuara shikimi.
- 3.1.13 T'i jape Pajtimtarit nje shpjegim te hollesisem te te gjitha kushteve te perdorimit dhe kontrates para nenshkrimit te kontrates.
- 3.1.14 T'i jape Pajtimtarit informacion te detajuar per programet tarifore qe mund te zgjedhe Pajtimtari, duke i dhene mundesine e krahasimit midis tyre, perfshire:
 - i. informacion te plote dhe te qarte, per paketat tarifore dhe ofertat promocionale apo speciale si zbritjet e tarifave, perdorim i pakufizuar i Internetit, duke specifikuar midis te tjerave cfare perfshihet ne pakete/oferte dhe cfare nuk perfshihet ne to, afatet kohore te ofertave dhe efektet e tejkallimit te tyre, perfshire tarifate e aplikuar.
 - ii. Sistemin tarifor te aplikuar per sherbimet si kufizime te perdorimit, menyra e tarifimit pas tejkallimit te kufizimit, njesia e matjes per tarifimin (p.sh. M/byte etj), ndryshimi i tarifave, etj
 - iii. Sherbimet shtese te perfshira ne paketen e zgjedhur
 - iv. Informacion per cilesine e sherbimeve te ofruara/zgjedhura perfshire informacion dhe sqarime per internetin.
- 3.1.15 Te mos refuzoje lidhjen ne rrjet te pajisjeve fundore qe jane ne perputhje me Ligjin nr. 9918 i ndryshuar dhe aktet nen-ligjore te tij.
- 3.1.16 Te aplikojte rritjen e tarifave se nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate, vetem pas ezaurimit te procesit te njoftimit te pajtimtarit nga Operatori:
 - Nepermjet njoftimit individual (mund te jete edhe me SMS apo telefonate) te pakten 30 (tridhjet) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre, ne rastin kur rritja e tarifave aplikohet nga Operatori. Njoftimi individual duhet te perfshije adresen se ku jane publikuar rritjet e tarifave, ne

rast se njoftimi nuk permban detaje te mjaftueshme te ndryshimeve;

- Nepermjet mjeteve te informimit publik, jo me pak se 7 (shtate) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre dhe ky njoftim duhet te behet per jo me pak se 3 (tre) dite rrjesht, ne rastin kur rritja e tarifave eshte miratuar nga AKEP me nje vendim te vecante.
- 3.1.17 Te aplikojte automatikisht edhe pa njoftim uljen e tarifave te nje apo me shume sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari ne kontrate, brenda paketes se zgjedhur ne Aneks.
- 3.1.18 Te mos vendose detyrim financiar per rilidhje ne rrjet nese nderpreja e sherbimit eshte kryer per shkak te gabimeve te Operatorit.
- 3.1.19 Sipas kerkeses se pajtimtarit, ne perputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregullator ne fuqi, te lejojte perdorimin e sherbimit te internetit te ofruar nga sipermarres te tjere nese kane kontrate/marveshje me operatorin.
- 3.1.20 Per kufizimet apo per nderprerjet e sherbimit, te cilat zgjasin me shume se 30 min, Operatori ka detyrimin te vere ne dijeni AKEP-in dhe pajtimtaret. Ky njoftim behet :
 - i. te pakten 48 ore me pare, ne rast te nje permiresimi, modernizimi ose mirembajtje te rrjetit;
 - ii. sa me shpejt te jete e mundur, por jo me vone se 48 ore, pas ndodhjes se kufizimit apo nderprerjes se shkakuar nga defekte apo demtime te rrjetit.
- 3.1.21 Te kryeje njoftimin e pajtimtarit me mjete elektronike (si p.sh. mesazh ne PC) jo me pak se 3 (tre) dite rresht para arrijtes se nivelit te kufizimit "download"/"upload" te percaktuar ne Aneksin I te Kontrates;
- 3.1.22 Operatori detyrohet te pranoje ankesat e pajtimtareve me shkrim dhe tu ktheje pergjigje brenda afateve te percaktuara ne rregulloren e AKEP per zgjidhjen e mosmarveshjeve pajtimtar-sipermarres.

3.2 PAJTIMTARI DETYROHET

- 3.2.1 Te siguroje me shpenzimet e tij pajisjet per lidhjen e Sherbimit te internetit.
- 3.2.2 Te kryeje pagesen per sherbimin e ofruar, sipas menyres dhe afateve te percaktuara ne nenin 6 te Kontrates.
- 3.2.3 Te likujdoje te gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, deri ne momentin e prishjes se kesaj Kontrate.
- 3.2.4 Te mos perdore sherbimin e ofruar per qellime ilegale dhe per te kryer vepra qe bien ne kundershim me Legjislacionin Shqiptar.
- 3.2.5 Te mos perdore sherbimin e internetit per qellime rishitje.
- 3.2.6 Te mos transferoje sherbimin ne palet e treta.
- 3.2.7 Te lidhe ne rrjet vetem pajisje te certifikuar dhe te sigurohet qe teknologjia e tyre eshte e pershtatshme me ate qe kerkohet ne sherbimin e internetit te Operatorit.

Neni 4. TE DREJTAT

4.1 OPERATORI KA TE DREJTET

- 4.1.1 T'i nderprese ofrimin e Sherbimit te internetit Pajtimtarit, i cili nuk ka zbatuar detyrimet qe rrjedhin nga pikat 3.2.2 -3.2.7.
- 4.1.2 Te nderprese sherbimin ne menyre te njeanshme, duke njoftuar te pakten 24 ore me perpara, per qellime mirembajtje dhe permiresimin e sherbimit. Kohezgjatja e nderprerjes te jete jo me shume se 48 ore;
- 4.1.3 Te ndryshojte tarifate e ofrimit te Sherbimit te internetit gjate vlefshmerise se kesaj kontrate.
- 4.1.4 Te modifikojte elementet e Kontrates, duke njoftuar pajtimtaret jo me pak se 30 dite perpara hyrjes ne fuqi te modifikimeve.

4.2 PAJTIMTARI KA TE DREJTE.

- 4.2.1 Te perdore pa kufizim Sherbimin e internetit ne perputhje me termat e kesaj kontrate.
- 4.2.2 Te kerkoje me shkrim ndryshime te tipit te paketes, shpejtesise se transmetimit apo te adreses (vendodhjes), per te cilat palet bien dakort.
- 4.2.3 Te kerkoje me shkrim prishje te kontrates ne menyre te njeanshme.
- 4.2.4 Te ndryshojte ne cdo kohe sherbimet e zgjedhura ne aneksin e kesaj kontrate nepermjet nje kerkeses/njoftimi me shkrim.
- 4.2.5 Te informohet nga Operatori per te gjitha modifikimet e propozuara ne kushtet e kontrates se pajtimtarit, brenda nje peridhje kohore jo me vone se 30 dite perpara dates se propozuar per hyrjen ne fuqi te ketyre modifikimeve, sipas percaktimeve ne nenin 10.
- 4.2.6 Te anulloje kontraten ne rast se nuk eshte dakort me modifikimin e kushteve te saj (perfshire rritjen e tarifave), duke njoftuar Operatorin me shkrim ose prane zyrave te tij, para afatit te hyrjes ne fuqi te tyre. Zgjidhja e kontrates nuk do te heqe detyrimet qe pajtimtari ka ne baze te kontrates se vjeter.
- 4.2.7 Pajtimtari, pavaresisht peraktimeve ne kete Kontrate, zeron te gjitha te drejtat qe i jep legjislacioni dhe kuadri nen-ligjor shqiptar ne fuqi, vecanerisht Ligji nr. 9918 i ndryshuar, Ligji nr. 9902 i ndryshuar, Ligji nr. 9887 i ndryshuar.

4.3 E drejta e ankimit:

1) Pajtimtari ka te drejte te ankohet apo te kerkoje sqarime tek operatori qe ofron sherbime te komunikimeve elektronike per kushtet kontraktore dhe/ose permbushjen e ketyre kushteve nga operatori, perfshire faturen dhe cilesine e sherbimit te ofruar.

2) Ne rast se pajtimtari nuk eshte i kenaqur me sqarimet e dhena nga operatori nepermjet telefonit apo njoftimeve te tjera me mjetet elektronike, ai mund te ankohet me shkrim. Ankesa duhet te paraqitet:

a) brenda 15 diteve nga marrja e fatures per sherbimin e ofruar, nese ankesa i referohet shumes se faturuar per sherbimin e ofruar; ose

b) brenda 15 diteve nga ofrimi i sherbimit, nese ankesa i referohet cilesise se sherbimit te ofruar.

3) Pas marrjes se ankese se referuar ne piken 2 te ketij neni, sipermarreses duhet te verifikojte shumen e faturuar per sherbimet e ofruara ose per cilesine e sherbimeve te ofruara dhe, pas verifikimit, te konfirmojte shumen e faturuar ose ta korrigoje ate. Sipermarreses i dorezon pajtimtarit pergjigjen, me shkrim, jo me vone se 15 dite pas marrjes se ankese nga pajtimtari.

4) Nese pajtimtari, nuk eshte dakord me pergjigjen me shkrim te sipermarreses, pajtimtari mund te filloje nje procedure ne AKEP per zgjidhjen e mosmarveshjes, sipas nenit 120/1 te ketij ligji, ose mund ta paraqese rastin para gjykates, sipas Kodit te Procedures Civile.

Neni 5 FATURIMI

5.1 Faturimi mujor per Pajtimtarin do te behet me parapagim.

5.2 Faturimi i pajtimtimit mujor:

i. do te perfishihet cdo muaj (si ze me vete) ne faturen e sherbimit internet te muajit paraardhesh, nese Pajtimtari perfiton nga Operatori sherbimin internet, ose

ii. do te kryhet me fature te vecante nese Pajtimtari nuk perfiton nga Operatori sherbimin internet.

Ne te dy rastet, fatura do te dergohet ne njesine perkatese arketimore te Operatorit dhe i dorezohet Pajtimtarit ne vendin e banimit, ne menyre zyrtare (me poste ose dorazi) dhe jo me vone se pesembdhjete dite kalendarike perpara afatit te pageses se saj.

5.3 Faturimi per mbipagesen do te behet ne faturen e muajit pasardhesh.

5.4 Ne faturen e derguar Pajtimtarit, pervec vlerave te detyrimeve, Operatori perfishin:

- Afatin e pageses se fatures;
- Menyren dhe vendin e pageses se fatures;
- Pagesat shtese;
- Sanskionet ne rast moshlyerje te detyrimeve (kamat-vonesat, nderpreje, kufizim te sherbimeve etj);
- Numer kontakti te Operatorit per Kujdes ndaj Klientit per informacion per faturen (thirrjet drejt ketij numri jane pa pagese ose me kosto jo me te larte se nje thirrje lokale).

Neni 6. KRYERJA E PAGESAVE

Detyrimet financiare te Pajtimtarit ndaj Operatorit kryhen si me poshte:

6.1 Per vleren e instalimit, me LEK ne dore, vetem njehere, prane arkesh se Operatorit ose me Urdher-Xhirimi ne emer dhe ne favor te Operatorit, sipas percaktimeve ne faturen eleshuar, ne momentin e firmosjes se kesaj Kontrate, referuar tarifave te percaktuara ne Aneks-Kontrate.

6.2 Per vleren e pajtimtimit mujor menjehere me ofrimin e sherbimit:

- a) me faturen mujore te sherbimit internet, sipas nenit 6.1.b te "Kontrates se Pajtimtimit" ne rrjetin publik te Operatorit, ne rast se Pajtimtari Perfiton nga Operatori sherbimin internet, ose
- b) Sipas afateve te fatures se vecante nese Pajtimtari nuk perfiton nga operatori sherbimin internet;
- c) per muajin e pare, me lek ne dore prane arkesh se Operatorit, ne momentin e firmosjes se kesaj Kontrate, sipas diteve kalendarike, duke fillur 2 dite pas dates se nenshkrimit te saj deri ne ditën e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore te sherbimit internet.

6.3 Detyrimet sipas pikes 6.2 duhet te shlyhen brenda 30 (tridhjete) diteve kalendarike te llogaritura nga dita e fundit e muajit te faturuar.

6.4 Date pagese do te konsiderohet:

- a) Data e shenuar ne mandat arketimi, ne rastin kur pagesa kryhet me LEK ne dore prane njesise arketimore te Operatorit.
- b) Data e prekjes se llogarise bankare likuiduese te Operatorit, ne rastin kur pagesa kryhet me Urdher-Xhirimi bankar.

Neni 7 SANKSIONET

7.1 Ne rast se sherbimi i kontraktuar nuk ploteson nivelin e cilesise se parashikuar ne kontrate dhe/ose Operatori vonon riparimin e difekteve ne rrjetin e tij te telekomunikacioneve, tej afateve te percaktuara ne pikat 3.1.4 te kesaj Kontrate, atehere ai detyrohet t'i zbrese fatures te muajit ne vijim 3% se tarifese se pajtimtimit mujor (me TVSH), per cdo dite mungese cilesie/vonese riparimi difekti, por jo me shume se vlera e tarifese se pajtimtimit mujor (me TVSH).

7.2 Ne rast se Pajtimtari vonon pagesen e vleftes se fatures mujore tej afateve te percaktuara ne piken 6.3 te kesaj Kontrate, atehere:

- a) Deri ne datën 15 te muajit pasardhesh, Pajtimtari detyrohet t'i paguaje Operatorit kamate ne masen 0.5 % te vlerese se fatures mujore te papaguar per cdo dite vonese.
- b) Ne datën 16 te muajit pasardhesh Pajtimtari i nderpritet ofrimi i sherbimit. Nga data 16 deri ne ditën e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore te muajit pasardhesh negociohet per zgjidhjen e mosmarveshjes, kryerjen e pageses se fatures mujore, kamate vonesat etj.

c) Nese pas perfundimit te afatit sipas pikes 7.2/b mosmarveshjet nuk zgjidhen atehere pajtimtari mund ti drejthet AKEP per zgjidhjen e mosmarveshjes ose ceshtja kalon per zgjidhje ne Gjykaten e Rrethit.

d) Diten e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore te muajit pasardhesh,

Kontrata quhet e nderprere.

7.3 Ne rast se Pajtimtari nuk kryen pagesen e fatures sipas afatit te saj, Operatori ka te drejte te ndermarre masa kufizuese te ofrimi te sherbimit per Pajtimtarin:

a. Operatori, brenda 15 diteve pas afatit te pageses, do te njoftoje Pajtimtarin me shkrim ose me SMS/telefonate per plotesimin e detyrimit te pageses apo detyrimeve te tjera kontratore, brenda nje afati te arsyeshem, jo me pak se 15 dite, te percaktuar nga Operatori si dhe duke e paralajmeruar Pajtimtarin per masat kufizuese qe mund te ndermarre Operatori.

b. Ne rast se Pajtimtari nuk kryen pagesen apo nuk permbush detyrimet kontratore brenda 30 diteve nga afati i pageses se fatures, Operatori ka te drejte te kufizojë apo nderprese perkohesisht ofrimin e sherbimeve. Ne kete rast, Operatori do te dergoje nje njoftim per palajmerimin e fundit dhe/ose fillimin e masave kufizuese/ nderprejtes te perkoheshme apo perfundimtare.

c. Ne rast se Pajtimtari nuk ka paguar detyrimin 60 dite pas afatit te pageses se fatures, Operatori ka te drejte te nderprese kontraten ne menyre te njeanshme, duke i derguar njoftim Pajtimtarit 10 dite perpara nderprejtes. Pas kesaj date me shlyerjen e te gjitha detyrimeve ndaj Operatorit, Pajtimtari ka te drejte te rilidhe Kontraten e Pajtimtimit.

7.4 Operatori nuk eshte i detyruar te njoftoje paraparakisht Pajtimtarin per masat e marra ne rast se shkelja e evidentuar e kontrates:

- i. perben nje kerccenim serioz te rendit e sigurise publike, shendetit e mjedisit;
- ii. shkakton nje demtim serioz fizik, material ose funksional te rrjetit

7.5 Nese eshte teknikisht e mundshme, Operatori eshte i detyruar te kufizojë aksesin vetem per ato sherbime qe Pajtimtari ka shkelur kushtet e kontrates, pervec rasteve kur Pajtimtari abuzon, ose ne menyre te perseritur kryen me vonese ose nuk paguan faturat.

7.6 Ne cdo rast kur Pajtimtari vonon pagesen e vlerese se fatures, tej afateve te percaktuara ne fature, dhe brenda ketij afati nuk ka bere ankese me shkrim per faturen, Pajtimtari detyrohet t'i paguaje Operatorit kamate ne masen 0.5% te fatures mujore te papaguar, per cdo dite vonese ne pagim nga afati i pageses se percaktuar ne fature.

7.7 Ne rast se Pajtimtari, ka bere ankese me shkrim per faturen, para afatit te pageses, atehere:

- a) Operatori ka detyrimin te trajtojë ankesen dhe ktheje pergjigje sipas percaktimeve te kesaj kontrate.
- b) Operatori mund te mos aplikojë masat kufizuese te referuara me siper.

Neni 8 PRISHJA E NJEANSHME E KONTRATES

8.1 Operatori mund te prishe kontraten ne menyre te njeanshme kur Pajtimtari nuk shlyhen pagesat e fatures sipas nenit 6 te kesaj Kontrate.

8.2 Pajtimtari ka te drejte ta quaj kete Kontrate te prishur ditën e fundit perpara nxjerrjes se fatures mujore pavarisisht nga data e paraqitjes se kerkesese se tij me shkrim.

8.3 Pajtimtari ka te drejte te zgjidhe Kontraten ne menyre te njeanshme dhe pa kosto shtese, ne rastet e modifikimit/zevendesimit te kontrates, nese nuk eshte dakort me kushtet e reja perfishire:

- rritje te tarifese se nje apo me shume sherbimeve;
- perkeqesim te treguesve te cilesise se sherbimit nga Operatori

Zgjidhja e kontrates nuk do te heqe detyrimet qe pajtimtari ka ne baze te kontrates se vjeter. Ne keto raste pajtimtari duhet te njoftoje Operatorin sipas percaktimeve te nenit 10.

Neni 9 KUSHTE TE PERGJITHSHME

9.1 Kjo Kontrate hartohet dhe interpretohet nga Palet ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore te Republikese se Shqiperise.

9.2 Mosmarveshjet qe lindin ndermjet paleve zgjidhen sipas percaktimeve ne Udhezuesin e Mosmarveshjeve me pajtimtarin te dhena si Aneks i kesaj Kontrate. Ne rast se palet nuk arrijne te zgjidhin mosmarveshjen me mirekuptim, secila mund ti drejtohet per shqyrtim AKEP-it ose/dhe Gjykatese se Rrethit ku eshte lidhur Kontrata.

9.3 Kjo Kontrate hyn ne fuqi ne ditën e nenshkrimit te saj nga palet.

9.1. Kjo kontrate lidhet per nje afat te percaktuar prej 12 (dymbedhjete) muajsh duke filluar nga data e nenshkrimit te kontrates prej pajtimtari.

9.2. Nese pajtimtari nuk ka njoftuar Operatorin me shkrim ose ne zyrtar e tij, se nuk deshiron vazhdimin e kontrates pertej afatit 12 (dymbedhjete) mujor, kontrata kthehet ne kontrate me afat te pacaktuar.

9.6. Pas kalimit te afatit fillestar prej 12 muajsh, pajtimtari mund ta zgjidhe kontraten duke njoftuar me shkrim Operatorin per kete ose me deklarim ne dyqanet e operatorit. Operatori do ta zgjidhe kontraten ne fund te muajit ne vazhdim, por asnjehere me vone se 30 (tridhjet) dite nga marrja e njoftimit nga ana e Operatorit. Ne rast se kontrata zgjidhet gjate muajit, tarifa mujore e pajtimtimit do te paguhet deri ne fund te muajit kalendarik gjate te cilit eshte zgjidhur kontrata.

- 9.7 Ne cdo rast zgjidhjeje te kesaj Kontrate duhet te shlyhen te gjitha detyrimet e Pajtimtarit kundrejt Operatorit.
- 9.8 Ne rast zgjidhjeje te Kontrates per shkak te mosshlyerjes se detyrimeve nga ana e Pajtimtarit, ai qofte personalisht, qofte si person juridik do te humbase te drejten te lidhe nje kontrate tjeter me Operatorin pa shlyer me pare detyrimet e tij te prapambetura ndaj Operatorit . Operatori do te ruaje te drejten e tij per te kerkuar sipas ligjit pagimin e detyrimeve te pashlyera.
- 9.9 Secila pale ka te drejte te kerkoje prishjen e njeanshme te kontrates, sipas percaktimeve te dhena ne kete kontrate.

Neni 10. MODIFIKIMI

- 10.1. Percaktimet e kesaj Kontrate dhe Udhzuesi per Zgjidhjen e Mosmarveshjeve perbejne Termat e Pergjithshme te Kontrates se lidhur midis Operatorit dhe Pajtimtarit, dhe jane miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP.
- 10.2. Termat e Pergjithshme te Kontrates mund te modifikohen apo zevendesohen vetem pas miratimit te ndryshimeve nga AKEP.
- 10.3. Per cdo modifikim/zevendesim te kushteve te pergjithshme, reduktimi te sherbimeve/cilesise dhe rritje te tarifave te sherbimeve te zgjedhura nga pajtimtari, Operatori duhet:
- Te njoftoje Pajtimtarin nepermjet njoftimit individual (mund te jete edhe me SMS apo me telefon te pakten 30 (tridhjet) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre. Njoftimi individual duhet te perfsihje adresen se ku jane publikuar ndryshimet/termat e reja, ne rast se njoftimi nuk permban detaje te mjaftueshme te ndryshimeve;
 - te njoftoje pajtimtaret nepermjet mjeteve te informimit publik, jo me pak se 7 (shtate) dite perpara hyrjes ne fuqi te tyre dhe ky njoftim duhet te behet per jo me pak se 3 (tre) dite rrjesht, ne rastin kur rritja e tarifave eshte miratuar nga AKEP me nje vendim te vecante.
- 10.4. Permiresimi i sherbimeve per pajtimtarin si ulja e tarifave dhe rritja e cilesise/sherbimeve mund te aplikohen nga Operatori pa qene nevoja e njoftimit.
- 10.5. Ndryshimet e cituara ne piken 10.3, hyjne ne fuqi ne daten e percaktuar nga AKEP (ne rast se ato jane objekt miratimi nga AKEP) ose nga Operatori.
- 10.6. Ne rast se pajtimtari nuk njofton me shkrim Operatorin, sipas pikes 10.7, pajtimtari konsiderohet se i pranon ne heshtje ndryshimet dhe efektet e ndryshimeve zbatohen nga data e hyrjes ne fuqi te tyre pa qene i detyrueshem nenshkrimi i tyre (te nje amendamenti apo kontrates se re) nga te dy palet . Palet kane te drejte te neshkruajne amendamentet apo kontraten e re, ne cdo kohe para apo pas hyrjes ne fuqi te ndryshimeve.
- 10.7. Ne rast se pajtimtari nuk eshte dakord me modifikimin e kushteve te kontrates (perfsihire rritjen e tarifave) te cituar ne piken 10.3, pajtimtari ka te drejte te mos pranoje modifikimin/zevendesimin e kontrates dhe ta anulojte kontraten duke njoftuar Operatorin me shkrim ose ne zyrat e tij, para afatit te hyrjes ne fuqi te tyre. Zgjidhja e kontrates nuk do te heqe detyrimet qe pajtimtari ka ne baze te kontrates se vjeter.

Kjo kontrate dhe gjithe elementet e saj hartohet ne 2 (dy) kopje te njevllefshme ne gjuhen shqipe, nga te cilat 1 (nje) kopje e mban Operatori dhe 1 (nje) kopje i dorezohet Pajtimtarit. Te dy kopjet nenshkruhen nga te dy palet.

Me ane te ketij nenshkrimi vertetohet se i kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet dhe termat e kesaj kontrate.

Neni 10. ADRESA (Kontaktet) :

Adresa:

NIPT:

Telefon:

Email:

PER OPERATORIN:

PAJTIMTARI:

Emer-mbiemer-firme-vule

Emer-mbiemer-nenshkrimi

ANEKSI nr.1

Sherbimet dhe Tarifat

Tabela e sherbimeve dhe tarifave per sherbimin internet:

Ne kete seksion pasqyrohen sherbimet baze dhe shtese te ofruara nga Operatori dhe te zgjedhura nga pajtimtari, tarifate perkatese te sherbimeve, menyra e tarifimit dhe parametrat teknike dhe cilesore te sherbimit.

Sherbimi internet: _____

CIR minimal: _____

Shpejtesia lidhjes: _____ Download dhe _____ Upload

Tarifa mujore: _____

Tarifa e abonimit: _____

Tarifa e instalimit: _____

Shenim: Tarifate e perditesuara gjenden ne faqen tone web. www.acenet.al

ANEKSI NR. 2

UDHEZUES PER ZGJIDHJEN E ANKESAVE

- 1- Ankesat mund te paraqiten :
 - a- Nepermjet numrit 0682080141 per “Difekte teknike”
 - b- Nepermjet numrit 0682080131 per “Asistence teknike per sherbimin internet” .
 - c- Nepermjet sporteleve te Operatorit ku merret deklarim shkresor per ankesen.
 - d- Nepermjet postes per ankesa te ndryshme.
 - e- Me email ne adresen info@acenet.al
- 2- Afati i paraqitjes se ankesave eshte:
 - a- Ankesat per “Difekte Teknike” dhe “Asistence teknike per sherbimin internet” paraqiten ne cdo kohe (sherbimi 24 oresh);
 - b- Ankesat per vendimet apo veprimet e Operatorit per aksesin apo veprimet te kryer nga Operatori.
 - c- Ankesat per faturim paraqiten deri ne fund te muajit te dyte pasardhes te fatures se ankmuar.
 - d- Ankesa per mos riparim te difekteve te paraqiten menjehere pasi mbaron afati sipas pikave perkatese te kontrates.
 - e- Ankesat e tjera, te cdo lloji qofshin paraqiten sa me pare.
- 3- Ankesat, ne varesi nga natyra e tyre, shqyrtohen nga strukturat perkatese e Operatorit, mbeshetur ne te dhenat e marra nga Deget apo Sektorret e tjere dhe konform rregullave behet analiza dhe zgjidhja e tyre, konform afateve te parashikuara ne Kontraten e Pajtimtarit.
- 4- Afati i nformimit me shkrim te Pajtimtarit mbi rezultatin e shqyrtimit te ankesave sipas pikave 2.b, 2.c,2.d, dhe 2.e eshte brenda 10 diteve nga marrja e tyre.
- 5- Operatori mban nje rregjister te vecante per ankesat e paraqitura sipas pikave 2.b, 2.c, 2.d dhe 2.e., dhe pergjigjet e dhena me shkrim sipas pikes 4, duke i dhene seciles nje numer refernce.
- 6- Pajtimtaret kane te drejte qe, ne perputhje me percaktimet ne kontrate per zgjidhjen e mosmarveshjeve, te ankohen ne:
 - a) AKEP per zgjidhjen e mosmarveshjes sipas rregullores se AKEP per zgjidhjen e mosmarveshjes,
 - b) Dhe/ose ne Gjykate per vendimin e marre nga Operatori.

ANEKSI NR. 3

Treguesit e Cilesise se Sherbimit Internet

Treguesit e Cilesise se Sherbimit Internet gjenden te perditesuar ne faqen tone web www.acenet.al



ACENET SH.P.K.

FORMULAR REGJISTRIMI
PER PERDORUESIT E SHERBIMIT AKSES NE INTERNET
Plotesimi i formularit behet me germ a te medha shtypi

<input type="checkbox"/> INDIVID	<input type="checkbox"/> PERSON FIZIK	<input type="checkbox"/> PERSON JURIDIK	<input type="checkbox"/> INSTITUCION PUBLIK E TE TJERE
Emri i personit fizik/juridik/institucionit publik e te tjere			
<input type="text"/>			
Numri i dokumentit te regjistrimit ne organin tatimor (Certifikate / NIPT): <input type="text"/>			
Adresa e plote: <input type="text"/>			
<input type="text"/>			

INFORMACION I PERDORUESIT

Emri	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Atesia	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Datelindja	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Vendlindja; Rrethi Shteti	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Shtetesia	<input type="text"/>	<input type="text"/>

REGJISTRIMI PRANE OPERATORIT BEHET NGA : Përdoruesi Personi i autorizuar Kujdestari ligjor

Dokumentat e nevojshem per regjistrim :

- Pasaporte (E zakonshme Sherbimi Diplomatike) (depozitohet fotokopje), ose
- Leternjoftim (depozitohet fotokopje), ose
- Certifikate lindje me fotografi (depozitohet)
- Certifikate familjare/Vendim gjykate(per rastin e regjistrimit nga kujdestari ligjor) (depozitohet)
- Autorizim / Prokure per rastin e regjistrimit nga Personi i autorizuar (depozitohet)

Dokumenti i identifikimit

Numer

Data e leshimit (data-muaji-viti)

KUJDES! Deklarimet e te dhenave te rreme apo paraqitja e dokumentave te falsifikuara per regjistrim ,perbejne krime te falsifikimit dhe/ose perdorimit te dokumentave te falsifikuara, qe parahikohen nga nenet 186, 189 ose 191 te Kodit Penal te Republikes se Shqiperise.

Perdoruesi / Kujdestari ligjor (per perdoruesit nen moshen 18 vjec)

_____ Data e regjistrimit (data-muaji-viti)

(emer mbiemer) (nenshkrimi)

Shenim: Ne rastet e parashikuara me ligj te dhenat e ketij formulari u vihen ne dispozicion autoriteteve te percaktuara ne Kodin e Procedures Penale, ne baze te kerkeses se tyre.

Per Operatorin ; _____

(emer , mbiemer i personit te autorizuar) (nenshkrimi)

Per cdo informacion ne lidhje me regjistrimin, kontaktoni me operatorin ne numrin +355682080131